



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 99 prot.

Tiranë, më 16.01. 2018

Lënda: Ridërgohet “*Rekomandim për marrjen e masave për eliminimin e situatës diskriminuuese në lidhje me trajtimin me karburant dhe lubrifikantë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë*”.

Drejtuar: **Znj. Ogerta MANASTIRLIU**
MINISTËR
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Z. Astrit HADO
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Për dijeni: **Znj. Blerta CANI**
DREJTOR EKZEKUTIV
FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA

TIRANË

Të nderuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri ose KMD), si institucion i pavarur publik, i cili është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur informacion nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK), sipas të cilit konstatohet se rregullimi ligjor dhe praktika e ndjekur në lidhje me trajtimin me karburant dhe mjete lubrifikuese të personave paraplegjik dhe tetraplegjik ka karakter diskriminues.

Bazuar në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në analizë të legjislacionit kombëtar në fuqi dhe atij ndërkombëtar të ratifikuar nga vendi ynë, Komisioneri arriti në konkluzionin se rregullimi ligjor dhe praktika e ndjekur në lidhje me trajtimin me karburant dhe mjete lubrifikuese të personave paraplegjik dhe tetraplegjik ka karakter diskriminues dhe vjen në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit.

Për këtë arsye, Komisioneri, përmes Shkresës me Nr. 589 Prot, datë 15.06.2015, dërgoi **“Rekomandim për marrjen e masave për eliminimin e situatës diskriminuese në lidhje me trajtimin me karburant dhe lubrifikantë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë”**.

Në përgjigje të kësaj shkrese, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i ka dërguar Komisionerit Shkresën Nr. 5116/1 Prot, datë 24.07.2015, me lëndë “Kthim përgjigje”.

Me shkresën datë 28.03.2017, protokolluar me tonën me Nr. 314 Prot, datë 30.03.2017, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK) ka bërë me dijeni Komisionerin se ka konstatuar në vazhdimësi raste në të cilat i’u mohohet e drejta për rimbursimin e karburantit dhe lubrifikantëve në kundërshtim me detyrimet ligjore. Gjithashtu, ka patur disa çështje në gjykate me objekt njohjen e të drejtës për rimbursimin e karburantit dhe lubrifikantëve për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Kështu, me vendimin Nr. 80-2016-670, datë 17.02.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, është shprehur se praktika e ndjekur nga institucionet Shtetërore, Drejtoria e Përfitimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, është në kundërshtim me ligjin dhe ka njohur të drejtën e rimbursimit për blerjen e karburanteve dhe lubrifikantëve për palën paditëse që është invalid me status paraplegjik.

Gjithashtu, me Vendimin Nr. 924 (80-2017-950) datë 09.03.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, ka njohur të drejtën e rimbursimit për blerjen e karburanteve dhe lubrifikantëve për 5 persona, invalid me status paraplegjik.

Në këto kushte, i’u drejtohem me këtë shkresë me qëllim marrjen e informacionit lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e **“Rekomandimit për marrjen e masave për eliminimin e situatës diskriminuese në lidhje me trajtimin me karburant dhe lubrifikantë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë”**, meqenëse Komisioneri konstaton se ligji dhe akti nënligjor janë ende në fuqi dhe kanë parashikim të drejtpërdrejtë për njohjen e se drejtës së rimbursimit për këtë kategori.

Lutemi përcjelljen e informacionit të sipërcituar, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e tij dhe zgjidhjen e situatës.

Bashkëlidhur dërgohet Shkresa me Nr. 589 Prot, datë 15.06.2015 e Komisionerit (e njëjsuar me origjinalin).

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

